

VENDIM
Nr. 258, datë 17.12.2018

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMIT TË SHOQËRISË
“RTS” SHPK, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE
NGA CENTRALI FOTOVOLTAÏK, NË ZONËN TREN-BILISHT TË RRETHIT
KORÇË, ME FUQI TË INSTALUAR 2 mw**

Në mbështetje të nenit 16, nenit 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa “a”; nenit 5, pika 1, germa “a”; nenit 10, pikat 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimi, transferimi, rinovimi ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, si dhe nenit 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 17.12.2018 mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut për fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “RTS” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, në zonën Tren-Bilisht të rrethit Korçë, me fuqi të instaluar 2 mw,

konstatoi se:

Shoqëria “RTS” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 747 prot., datë 22.11.2018, ka paraqitur aplikimin, për t’u pajisur me licencë në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik në zonën Tren-Bilisht të rrethit Korçë, me fuqi të instaluar 2 mw.

Aplikimi i shoqërisë “RTS” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1, gjerat “a”, “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gjerat “a”, “b”, “c”, “e” dhe “f”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, gjerat “b” dhe “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.4.1, pika 4.4.2, pika 4.4.3, pika 4.4.4, pika 4.4.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Në lidhje me mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me:

- Nenin 9, pika 2, germa “d” (vërtetimi nga Prokuroria, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor të Shkallës së Parë Tiranë). Plotësuar pjesërisht. Subjekti ka përcjellë në ERE vërtetimin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor të Shkallës së Parë Tiranë, të datës 2.11.2018, për administratorin z. Edmond Zalla mungojnë vërtetimi i Prokurorisë dhe i Gjykatës për vetë subjektin “RTS” sh.p.k.

- Nenin 9, pika 2, germa “g”, dokumente që vërtetojnë pronësinë e aplikuesit në zonat ku do të shtrihet projekti (kontrata shitblerje, kontrata qiraje, akte dhurimi, kontrata premtim shitblerje, marrëveshje me subjektet që kanë në pronësi zonat ku shtrihet projekti për ato veprimtari që përdorin asete për kryerjen e veprimtarisë së licencuar).

- Aplikuesi ka paraqitur kontratën e qirasë nr. 1890 rep. dhe nr. 1077/3 kol., datë 11.9.2018, të lidhur me qiradhënësin Bashkia Devoll, për një afat 20-vjeçar, por në të cilën nuk parashikohet e drejta e përsëritjes, e cila nuk mbulon periudhën e jetëgjatësisë së paneleve e cila është parashikuar të jetë 25 vjet.

- Nenin 9, pika 3, germa “a”, vërtetimi për shlyerjen e tatim-taksave dhe detyrimeve ndaj Institucionit të Sigurimeve Shoqërore (për shoqëritë e sapokrijuara vërtetim që nuk ka detyrime):

plotësuar pjesërisht. Subjekti ka paraqitur vërtetimin nga Drejtoria Rajonale e Tatim-Taksave Korçë. Nuk ka paraqitur vërtetimin për sigurimet shoqërore.

- Nenin 9, pika 3, germa “c” (dokumente që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit). Plotësuar pjesërisht. Për financimin e projektit që do të realizohet në masën 30% nga ortakët, subjekti nuk ka depozituar në ERE dokumente mbështetëse.

- Do të njoftohet subjekti që në bazë të nenit 11, pika 1, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”.

- Subjekti “RTS” sh.p.k. ka lidhur kontratën me nr. 2156 rep. dhe nr. 115/6 kol., datë 8.10.2018, me MIE-n për një afat 49-vjeçar (dyzetënëntëvjeçar), por nga ana tjetër ERE në zbatim të nenit 38, të ligjit “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, dhe nenit 5 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, nuk mund të japë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike një licencë me afat më të gjatë se 30 vjet. Por duke qenë se nga të dhënat për projektin e centralit rezulton se jetëgjatësia e pritshme e një paneli është 25 vjet, atëherë ERE kushtëzohet nga kjo jetëgjatësi në dhënien e afatit maksimal për një licencë fotovoltaike, deri në 25 vjet.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë e procedurën për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “RTS” sh.p.k., për licencim në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Centrali Fotovoltaike në zonën Tren-Bilisht të rrethit Korçë, me fuqi të instaluar 2 mw, për një afat 25-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti